

Udhëzime për familjarët apo kujdestarët e fëmijëve.

Të nderuar familjarë!

Në situatën që na vendosi COVID-19, ne duhet të bashkëpunojmë në një nivel maksimal që të mundësojmë zhvillimin e procesit mësimor në shkollë dhe jo në formate të kombinuara shkollë-online, apo vetëm online. Bazuar në këtë synim janë hartuar disa udhëzime dhe çdo udhëzim është një përgjegjësi e të dy aktorëve kryesore të përfshirë, shkollë-familje, për të zhvilluar me sukses procesin mësimor në shkollë. Lista e detajuar e udhëzimeve paraqitet si më poshtë:

1. Nxënësi duhet të ketë vetëm çantë shpine dhe mundësisht një vend të dedikuar për shishen e ujit (Jo çanta me rrota).
2. Shishja e ujit të jetë sa më e sigurt, që të mos derdhet gjatë transportit të fëmijës tuaj.
3. Shishja e ujit të jetë e mbushur me ujë dhe më pas, ajo do të rimbushet në rast nevojë në ambientet e shkollës nga aparatet e ujit.
4. Nuk lejohet asnjë ushqim në klasë dhe nxënësi e ka të ndaluar rreptësisht të sjellë ushqim nga shtëpia. Shërbimi i ushqimit do të vazhdojë në shkollë në 2 vakte (mëngjes- drekë), por i sigurt dhe në ambiente të hapura, të mbuluara vetëm nga sipër, ndërsa dreka në mensën e shkollës, duke ruajtur distancën në tavolina dhe me turne, për klasat I-III, IV-VI, VII-IX. Lidhur me klasat X – XII, do të konsumojnë vaktet në ambiente të hapura, por të mbuluara nga sipër. Do t’ju tregojmë dy video ilustruese, sesi do të shërbehet ushqimi.
5. Ushqimi do të jetë i gatuar nga shkolla, i paketuar dhe i shëndetshëm. Do të mundohemi që në ushqimin e nxënësve të ketë sa më shumë zarzavate, sidomos nga perimet e prodhuara në territorin e shkollës.
6. Nuk do të shërbehen lëngje në shkollë, sipas rregullores së dërguar nga MSH.
7. Maska është e detyrueshme për të gjithë nxënësit nga parashkollorët deri në klasën XII. Kjo edhe për faktin që fëmija transportohet me mjetet e shkollës (do të zbatohen protokollet për numrin e nxënësve për një mjet, në masën 70%). Fëmija juaj gjatë javës duhet të pajiset edhe me kuti me maska rezervë (të paktën 5 maska në javë), të vendosura në çantë. Gjithashtu, duhet të ketë të paktën 2 pako facoleta dhe dezinfektant.
8. Marrja e nxënësve do të fillojë në orën 07:10, me përjashtim të familjeve që do të lajmërojmë vetë. Në çdo automjet është mësuesi përgjegjës, i cili ju lajmëron me telefon, kur është 10 minuta larg nga vendbanimi juaj. Gjatë kësaj kohe, ju duhet të shoqëroni fëmijën tuaj personalisht te mjeti i transportit, për shkak se ne dëshirojmë të mundësohet komunikimin me përgjegjësin e furgonit çdo ditë. Para orës 07:10, duhet të keni matur temperaturën e fëmijës tuaj dhe në mënyrë të përgjegjshme t’ia dërgoni me sms mësuesit përgjegjës të furgonit. Ndërsa në pritjen e përditshme në shkollë, ajo do të rimatet me aparat dixhital. Do t’iu dërgojmë një video se si do të jetë pritja e nxënësve në mëngjes.
9. Orët mësimore do të jenë 45 min, por të njëpasnjëshme, sipas këtij shembulli:
Ora e parë matematikë ndiqet nga ora e dytë, përsëri matematikë (sipas udhëzimeve të MASR) dhe të dyja në total 90 minuta. Pas këtyre dy orëve ka pushim në ambientet e jashtme, për 45 minuta (Përjashtim bëjnë vetëm ditët me shi). Në ditë do të bëhen 4-6 orë mësimore nga 45 minuta të njëpasnjëshme, prandaj do të kujdeseni që në çantën e fëmijës tuaj të jenë vetëm 2-3 libra të asaj dite, sipas orarit që do të dërgojmë para fillimit të shkollës.
10. Nxënësve do t’u vihen në dispozicion librat mbi bankë së bashku me çmimet përkatëse, që në ditën e parë të shkollës (çdo mungese do të plotësohet sa më shpejt). Librat “Maths” dhe “Science” do të merren pak më vonë.

Të nderuar prindër, ju bëjmë me dije se shpërndarësit e librave na kanë lënë vetëm 5 ditë kohë për të bërë pagesat. Prandaj, do t'iu luteshim që duke filluar nga dita e dytë e shkollës, të mund të kryeni pagesën e librave. (Nuk do të kërkohet pagesa e librave të "Maths" dhe "Science", sepse do t'i paguani në momentin që do të vijnë nga Cambridge Education). Ju këshillojmë që fëmija juaj të mos ketë disa fletore, sidomos dy javët e para, por 1 fletore të trashë, sepse këto dy javë ne do të bëjmë përsëritje për të gjitha lëndët.

11. Në periudhën e parë (tre muaj), për arsye higjiene në kushtet e pandemisë Covid 19, nxënësit nuk janë të detyruar të paraqiten me uniformë në shkollë. Megjithatë, veshja duhet të jetë korrekte (jo strece, xhinse të grisura e tuta). Këto nformacione do të dërgohen edhe nga mësuesi kujdestar në Whatsapp.

Nëse do të na lindë ndonjë nevojë për të shkëmbyer informacion, do ta dërgojmë në Whatsapp, por edhe në faqen tonë të web-it.

Ju lutemi, vizitoni faqen tonë të shkollës për të parë përditësimet e fundit dhe na jepni sugjerimet tuaja.

Bashkëpunimi vazhdon...